



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në mbështetje të nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.27 dhe nënparagrafi 1.31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur më __/__/2023, miraton:

RREGULLORE NR. __/2023
PËR PLOTËSIMNDRYSHIMIN E RREGULLORES NR.06/2019 PËR EMËRIMIN E
KRYEPROKURORIT TË SHETITIT DHE KRYEPROKURORËVE TË PROKURORIVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 1

Neni 3 dhe 4 i Rregullores bazë ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

1. Kandidati për Kryeprokuror të Shtetit dhe Kryeprokuror duhet të plotësojë kushtet e përgjithshme si në vijim:

- 1.1. të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
- 1.2. të mos jetë i dënuar për veprë penale, përjashtimisht veprave penale të kryera nga pakujdesia;
- 1.3. të mos ketë aktakuzë të ngritur, përjashtimisht atyre të ngritura për vepra penale të kryera nga pakujdesia;
- 1.4. të ketë vlerësim të dalluar apo të mirë të performancës në dy (2) vlerësimet e fundit të rregullta;
- 1.5. të tregojë dhe dëshmojë integritet të lartë dhe aftësi menaxheriale;
- 1.6. të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore, me përjashtim të qortimit apo vërejtjes jopublike në pesë (5) vjetët e fundit.

2. Përveç kriterëve të parapara në paragrafin 1 të këtij neni, për të ushtruar funksionin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë, kandidati duhet të plotësojë edhe kriteret e veçanta si në vijim:

- 2.1. për të ushtruar funksionin si Kryeprokuror i Shtetit, kandidati duhet të jetë prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit apo të ketë së paku tetë (8) vjet përvojë pune si prokuror i shtetit, nga të cilat pesë (5) vjet si prokuror në Prokurorinë e Apelit, Prokurorinë Speciale, Departamentin për Krime të Rënda apo Departamentin për të Mitur.
- 2.2. për ta ushtruar funksionin si Kryeprokuror i Prokurorisë së Apelit, kandidati duhet të jetë prokuror në Prokurorinë e Apelit apo të ketë së paku shtatë (7) vjet përvojë pune si

prokuror i shtetit, nga të cilat tri (3) vjet si prokuror në Departamentin për Krime të Rënda apo Departamentin për të Mitur;

2.3. për të ushtruar funksionin si Kryeprokuror i Prokurorisë Speciale, kandidati duhet të jetë prokuror në Prokurorinë Speciale apo të ketë së paku gjashtë (6) vjet përvojë pune si prokuror i shtetit, nga të cilat tre (3) vjet si prokuror në Departamentin për Krime të Rënda apo Departamentin për të Mitur;

2.4. për të ushtruar funksionin si Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore, kandidati duhet të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë pune si prokuror i shtetit.

3. Periudha e ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë Speciale llogaritet si përvojë e prokurorit në Departamentin e Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore.

Neni 2

Neni 5 paragrafi 8 i Rregullores bazë ndryshohet dhe plotësohet.

Riformulohet si në vijim:

Anëtarët prokurorë të KPK-së, gjatë mandatit dhe dy vjet pas përfundimit të mandatit si anëtarë të KPK-së nuk mund të aplikojnë për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, Kryeprokurorit dhe Zëvendëskryeprokurorit.

Neni 3

Neni 10, paragrafi 2, ndryshohet, ashtu që nënparagrafi 2.2 fshihet nga rregullorja bazë dhe rregullohet renditja e nënparagrafëve.

Neni 4

Neni 18 i Rregullores bazë ndryshohet dhe plotësohet.

Riformulohet titulli i nenit 18, si në vijim: **Kriteret e përgjithshme për Zëvendëskryeprokuror të Shtetit dhe Zëvendëskryeprokuror** dhe pastaj vazhdon riformulimi i këtij neni si në vijim:

1. për të ushtruar funksionin e Zëvendëskryeprokurorit të Shtetit dhe Zëvendëskryeprokurorit, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

- 1.1. të jetë prokuror me së paku katër (4) vjet përvojë pune në prokurorinë përkatëse;
- 1.2. të mos ketë aktakuzë të ngritur, përjashtimisht atyre të ngritura për vepra penale të kryera nga pakujdesia;
- 1.3. të mos jetë i dënuar për vepra penale, përjashtimisht veprave penale të kryera nga pakujdesia;
- 1.4. të ketë vlerësim pozitiv të performancës në tre (3) vjetët e fundit;
- 1.5. të tregojë dhe dëshmojë integritet të lartë dhe aftësi menaxheriale;

- 1.6. të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore, me përjashtim të qortimit apo vërejtjes jopublike në pesë (5) vjetët e fundit.

Neni 5

Neni 19 i Rregullores bazë ndryshohet dhe plotësohet.

Riformulohet titulli i nenit 19 si më poshtë:

Kriteret e përgjithshme për Udhëheqës të Departamentit dhe vazhdon riformulimi i nenit si në vijim:

1. Për të ushtruar funksionin e Udhëheqësit të Departamentit, kandidati duhet t'i plotësojë kushtet si në vijim:
 - 1.1. të ketë së paku katër (4) vjet përvojë pune si prokuror;
 - 1.2. të mos ketë aktakuzë të ngritur, përjashtimisht atyre të ngritura për vepra penale të kryera nga pakujdesia;
 - 1.3. të mos jetë i dënuar për vepër penale, përjashtimisht veprave penale të kryera nga pakujdesia;
 - 1.4. të ketë vlerësim pozitiv të performancës në tre (3) vjetët e fundit;
 - 1.5. të tregojë dhe dëshmojë integritet të lartë dhe aftësi menaxheriale;
 - 1.6. të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore, me përjashtim të qortimit apo vërejtjes jopublike në pesë (5) vjetët e fundit;
 - 1.7. të ketë qenë i caktuar në periudhë prej së paku dy (2) vjet në atë departament.

Neni 6

Shtohet nenin i ri i Rregullores bazë, si nen 20, me këtë riformulim:

Zgjedhja dhe mandati i Zëvendëskryeprokurorit të Shtetit, Zëvendëskryeprokurorit dhe Udhëheqësit të Departamentit dhe vazhdon riformulimi i nenit si në vijim:

1. Zëvendëskryeprokurori i Shtetit zgjedhet nga Këshilli, me propozim të Kryeprokurorit të Shtetit, për një mandat katër (4) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje edhe për një (1) mandat.
2. Zëvendëskryeprokurori zgjidhet nga Këshilli, me propozim të kryeprokurorit përkatës, për një mandat katër (4) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje edhe për një (1) mandat.
3. Udhëheqësit e departamenteve të përcaktuar me këtë ligj zgjedhen nga Këshilli, në bazë të propozimit të kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse, për një mandat katër (4) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje edhe për një (1) mandat.

Neni 7

Neni 20 i Rregullores bazë riformulohet, si në vijim:

Neni 20 bëhet neni 21 dhe pastaj nenet në vijim vazhdojnë deri në fund të rregullores hyrja në fuqi dhe riformulohet si në vijim:

1. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit dhe Zëvendësit të tij, Kryeprokurorit dhe Zëvendësit të tij dhe Udhëheqësit të Departamentit, përveç në mënyrë të rregullt, përfundon edhe për këto shkaqe:

- 1.1. dorëheqje;
- 1.2. shkarkim;
- 1.3. vdekje;
- 1.4. arritjen e moshës së pensionimit dhe
- 1.5. kur dënohet për vepër penale, përjashtimisht veprave penale të kryera nga pakujdesia.

2. Përveç sipas paragrafi 1 të këtij neni, mandati i Kryeprokurorit të Shtetit dhe Zëvendësit të tij, Kryeprokurorit dhe Zëvendësit të tij dhe Udhëheqësit të Departamentit, përveç në mënyrë të rregullt, përfundon edhe për këto shkaqe:

- 2.1. kur dështon në përmbushjen e detyrave të përcaktuara me ligj;
- 2.2. kur vlerësimi i performancës nga ana e KVPP-së është i pamjaftueshëm;
- 2.3. kur nuk i zbaton udhëzimet e përgjithshme dhe vendimet e Kryeprokurorit të Shtetit dhe KPK-së dhe
- 2.4. për shkak të keqmenaxhimit.

3. Kryeprokurori i Shtetit dhe Zëvendësi i tij, Kryeprokurori dhe Zëvendësi i tij dhe Udhëheqësi i Departamentit do të vazhdojë punën pas përfundimit të mandatit në pozitën e prokurorit në prokurorinë ku kanë shërbyer, respektivisht, pas përfundimit të mandatit të Kryeprokurorit të Shtetit do të vazhdojë punën si prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

Neni 8

Neni 22 i Rregullores bazë riformulohet në paragrafin 1 dhe 2, ashtu që në vend të nenit 20 shkruhet 21.

Neni 9

Plotësohet dhe ndryshohet formulari për Konceptdokumentin për Kryeprokuror të Shtetit dhe kryeprokurorë në përputhje me ndryshimet e kësaj rregulloreje.

Neni 10 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Jetish Maloku

Prishtinë, më 26 qershor 2023

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës